



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1721 / 2 Prot.

Vlorë më, 27.06 2025

VENDIM

Nr. 66, datë 26.06.2025

PËR

**MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN NR.24, DATË 08.05.2018
"PËR RREGULLOREN E PËRDORIMIT TË ITHENTICATE SOFTWARE-IT PËR
DETEKTIMIN E PLAGJIATURËS NË VEPRIMTARINË KËRKIMORE DHE
BOTUESE NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË**

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja d, të ligjit nr. 80/ 2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 19, pika 1, gërma dh, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë si dhe referuar shkresës nr.1713/1, prot, datë 25.06.2025, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 26.06.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë disa ndryshime në vendimin nr.24, datë, 08.05.2018 "Për Rregulloren e përdorimit të ithenticate softwar-it për detektimin e plagjiaturës në veprimtarinë kërkimore dhe botuese në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë", sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Vendimi protokollohet dhe bëhen njoftimet përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËNKRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF. ASOC. DENADA SOTA

